



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 1975/ Prot.

Pogradec, më 10.05.2021

VENDIM

NR. 43 , DATË 06 . 05 .2021

“PËR MIRATIMIN E PROJEKT - PREVENTIVIT SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E FONDIT PËR NDËRTIMIN E MURIT MBAJTËS TËK LAGJIA PROI I CAPRAZIT”.

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, të pikës 1 të nenit 29, të ligjit nr. 139/2015, “Për Veteqeverisjen Vendore”, të neneve 4, 7 dhe 41, të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile” dhe të kapitullit III të V.K.M nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerezore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë:

VENDOSI :

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Pogradec për vlerën e fondit prej **2'000'000 lek me TVSH** për të investuar në ndërtimin e murit mbajtës tëk lagjia Proi i Çaprazit, për të evituar rrëshqitjen e dheut afër objektit të banimit të Z. Elton Vila dhe Z. Gentjan Kulla.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Pogradec.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Emergjencave Civile, Strehimi dhe objekteve në Bashkëpronësi, si dhe Drejtoria e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare, të Bashkisë Pogradec.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

Sotirag MANGËRI

